



# Kosova përfshihet në ECMI



European Economic  
and Social Committee

**Kosova do të jetë pjesë e Nismës për Anëtarët Kandidatë për Zgjerim (ECMI), të udhëhequr nga Komiteti Ekonomik dhe Social European.**




**EESC është trupë këshilluese e BE-së që nga 1957, që sjell zërin e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe partnerëve socialë të Europës në politikëbërje.**

*Përmes opinioneve të tij, ky komitet këshillon vendimmarrësit e BE-së dhe siguron dialog të strukturuar me publikun european.*

# Mobilizim i 104 OJQ-ve

**KCSF** përmes Rrjetit Ballkanik për Zhvillim të Shoqërisë Civile (**BCSDN**) mobilizoi një fushatë avokuese me mbështetjen e 104 organizatave nga i gjithë rajoni.



Me takime të nivelit të lartë në Bruksel dhe rajon, si dhe reagime publike, **kjo kampanjë me sukses ka argumentuar se mungesa e statusit kandidat të Kosovës nuk duhet të pengojë përfshirjen e shoqërisë civile në nisma të tilla.**

*Ky moment dëshmon se  
përpjekja, këmbëngulja dhe  
solidariteti japin rezultat, dhe  
se shoqëria civile mund ta  
afrojë Kosovën më pranë  
Bashkimit Evropian.*